



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.** **Tiranë** ___/___/2020

Nr. Dok.

Lënda: *Rekomandohet ndryshimi i udhëzimeve të dhëna nëpërmjet shkresës Nr.9657 Prot., datë 18.10.2017 "Tërheqje vëmendje mbi problematikat e konstatuara në lidhje me praktikën e lejeve shpërblyese në IEVP" duke njehsuar praktikën në përputhje me legjislacionin që rregullon kriteret e dhënies së lejeve shpërblyese.*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

Tiranë

I nderuar Z. Ismaili,

Në muajin Nëntor 2018, i dënuari Dh. Ç., na është drejtuar me një ankesë duke pretenduar se Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve i kishte refuzuar pa të drejtë, kërkesën për të përfituar leje shpërblyese.

Për verifikimin e kësaj ankese i jemi drejtuar fillimisht Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin, ku vuante dënimin ankuesi. Në përgjigjen që kemi marrë nga ky institucion me shkresën Nr.6132 Prot., datë 12.12.2018 jemi vënë në dijeni se, i dënuari nuk kishte shkuar me leje shpërblyese, sepse Bordi i Monitorimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve e kishte vlerësuar përgjigjen e komisariatit të policisë si të përciptë dhe jo sipas formatit të kërkuar. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin kishte kërkuar sërish informacion në Komisaratin e Policisë Sarandë në lidhje me këtë rast. Pas interesimit tonë, Komisarati i Policisë Sarandë na vuri në dijeni se i kishte kthyer përgjigje IEVP Peqin, në të

cilën kishte dhënë mendim pozitiv për të dënuarin sipas formatit të kërkuar. Në vazhdim të hetimit administrativ, i kërkuam sërish informacion IEVP Peqin nëse i dënuari Dh. Ç. kishte përfituar ose jo leje shpërblyese. Në përgjigjen e ardhur me shkresën Nr.383 Prot., datë 28.01.2019 thuhet se, të dënuarit Dh. Ç. i është refuzuar kërkesa për të përfituar leje shpërblyese, sepse gjatë tre muajve të fundit të qëndrimit në atë institucion, ai nuk kishte patur takim me familjen. Në kërkesën e radhës¹, iu drejtua IEVP Peqin duke parashtruar pyetjet si më poshtë:

- Në cilin akt ligjor parashikohet se të dënuarit i refuzohet kërkesa për të përfituar leje shpërblyese nëse ai nuk ka marrë takim me familjarët?
- Cila është arsyeja që i dënuari Dh. Ç. nuk ka marrë takim me familjarët, pamundësia e tyre ekonomike apo marrëdhëniet jo të mira?
- Ku është vendbanimi i të dënuarit Dh. Ç.?
- A është trajtuar me leje shpërblyese i dënuari Dh. Ç. gjatë vitit 2019?

Në përgjigjen që morëm nga ana e tyre me shkresën Nr.68 Prot., datë 13.01.2020 shpjegohet si vijon:

- *“Një i dënuar, që të trajtohet me leje shpërblyese duhet të plotësojë disa kriterë, bazuar në shkresën Nr.9657 Prot., datë 18.10.2017 “Tërheqje vëmendje mbi problematikat e konstatuara në lidhje me praktikën e lejeve shpërblyese në IEVP”, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, dalë në zbatim të Ligjit Nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” dhe Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve. Pra, që një i dënuar të dalë me leje shpërblyese duhet të ketë familjen ku të shkojë dhe të kalojë ditët që do të trajtohet me leje.*
- *Sipas deklarimeve të bëra nga vetë i dënuari, ai është shprehur se familja e tij jeton në Greqi dhe nuk kanë mundësi t'i vijë në takim, se nuk dëshiron që ata të lenë punën e tyre për t'i ardhur në takim. Për sa i përket marrëdhënieve të mira apo jo me familjen, i dënuari nuk është shprehur.*
- *Sipas akteve të administruara në dosjen penale rezulton se është banor i qytetit të Sarandës.*
- *Duke qenë se nga Komisariati i Policisë nuk është kthyer përgjigje definitive në lidhje me pikat që u kërkuar, deri në datën 27.02.2019 kur i dënuari u lirua nga institucioni, ai nuk është trajtuar me leje shpërblyese”.*

Verifikimi i këtij rasti vijoi nga ana jonë për të parë e analizuar në përgjithësi një problematikë të vëne re në sistemin e përfitimit të lejeve shpërblyese duke marrë shkas nga rasti në fjalë. Për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të dala nga hetimi, sikurse janë ato nëse mund t'i refuzohet kërkesa për leje shpërblyese një të dënuari nëse ai nuk ka marrë takim me familjarët; apo nëse e përcakton legjislacioni në fuqi si kriter kufizues takimin me familjarët; është e nevojshme të analizojmë aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë të drejtën e të dënuarve për leje shpërblyese.

Kriteret për dhënien e lejes shpërblyese janë parashikuar në nenin 59 të ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”i ndryshuar; në nenin 50/2 dhe 51/1 të “Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, miratuar me

¹ Kërkesa për informacion me pyetjet përkatëse i është drejtuar dy herë në mënyrë të përsëritur IEVP Peqin.

VKM nr. 437, datë 20.05.2015; Udhëzimin Nr. 103, datë 14.02.2014 “Për rregullimin e disa çështjeve që kanë të bëjnë me procedurën e dhënies së lejeve shpërblyese apo të veçanta personave të dënuar me burgim” të Ministrit të Drejtësisë, pikat 13, 14, 15 dhe 18.

Më konkretisht, në Ligjin nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” i ndryshuar parashikohet se:

Neni 59

Lejet shpërblyese

“Të dënuarit, të cilët respektojnë rregullat e disiplinës dhe rregulloren e brendshme të institucionit, që janë të motivuar për të marrë pjesë në programet rehabilituese e të riintegrimit dhe nuk paraqesin rrezikshmëri shoqërore, kanë të drejtë të marrin leje shpërblyese, por jo më shumë se 20 ditë në vit.

Leja shpërblyese i jepet:

a) personave të dënuar deri në 3 vjet burgim, pasi të kenë vuajtur jo më pak se 1/4 e dënimit; b) personave të dënuar nga 3 deri në 10 vjet burgim, pasi të kenë vuajtur jo më pak se 1/2 e dënimit;

c) Personave të dënuar mbi 10 vjet burgim, pasi t’u ketë mbetur për të vuajtur më pak se 5 vjet heqje lirie.

Leja shpërblyese në burgjet apo seksionet e sigurisë së lartë jepet vetëm me urdhër të Ministrit të Drejtësisë ose me autorizimin e tij nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.

Brenda 7 ditëve nga marrja e kërkesës për leje, institucioni ku kryhet dënimi miraton lejen shpërblyese. Koha e dhënies së lejes përcaktohet sipas një grafiku të miratuar nga drejtori i institucionit që në fillim të vitit.

Në rast refuzimi të dhënies së lejes, i dënuari ose përfaqësuesi i tij ligjor ka të drejtë të bëjë ankim pranë Ministrit të Drejtësisë, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative brenda 5 ditëve dhe më pas ka të drejtë të ankohet në gjykatë, e cila vendos për kërkesën për leje.

Procedurat e dhënies së lejeve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Drejtësisë”.

Ndërsa në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, parashikohet si më poshtë:

Neni 50

Shqyrtimi i kërkesave për leje shpërblyese apo të veçanta

“1. Drejtori i IEVP-së është autoriteti përgjegjës për dhënien e lejeve shpërblyese dhe të veçanta për të dënuarit.

2. Miratimi apo refuzimi i kërkesave për leje shpërblyese apo të veçantë duhet të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuara në nenet 59 dhe 75/5², të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, me kërkesat e kësaj rregulloreje, si dhe me udhëzimin e Ministrit të Drejtësisë.

² Sqarojmë se neni 75/5 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve rregullon lejet e veçanta për të paraburgosurit. Në rastin e trajtuar shtetasi Dh. Ç. ka pasur statusin e të dënuarit dhe ka bërë kërkesë për leje shpërblyese.

3. Drejtoritë e IEVP-ve në çdo fillim viti dërgojnë planifikimin vjetor të lejeve shpërblyese të të dënuarve që plotësojnë kriteret ligjore, të ndarë sipas një grafiku të përcaktuar.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve pas marrjes së planifikimit nga çdo IEVP, ngrë Bordin e Monitorimit të dhënies së lejeve shpërblyese dhe të veçanta.

5. Kërkesat për leje të veçanta i drejtohen Drejtorit të IEVP-së dhe regjistrohen në Regjistrin e lejeve të të dënuarve”.

Neni 51

Lejet shpërblyese

“1. Të dënuarit, të cilët respektojnë rregullat e disiplinës dhe rregulloren e brendshme të institucionit, dhe janë të motivuar për të marrë pjesë në programet rehabilituese e të riintegrimin apo nuk paraqesin rrezikshmëri shoqërore, kanë të drejtë të marrin leje shpërblyese, deri në 20 ditë në vit.

2. Planifikimi i lejeve shpërblyese bëhet sipas një grafiku të përcaktuar në fillim të vitit dhe nuk mund të zgjasë më shumë se 7 ditë.

3. Brenda 7 ditëve nga marrja e kërkesës për leje shpërblyese, Drejtori i IEVP-së vendos miratimin ose jo të saj, duke u bazuar në planifikimin vjetor dhe raportet e vlerësimit të përgjegjësve të sektorit të sigurisë, sektorit të çështjeve shoqërore dhe sektorit ligjor. Në raportet e vlerësimit përfshihen respektimi i kërkesave ligjore, vlerësimi i sjelljes së të dënuarit, vlerësimi i riskut, pjesëmarrja e tij në programe rehabilituese dhe riintegruese ose në programe të tjera brenda institucionit, besueshmëria që paraqet i dënuari për kthimin e tij në institucion, ekzistenca ose jo e masave disiplinore, marrëdhënia me familjen, si dhe çdo aspekt tjetër që ka të bëjë me profilin e të dënuarit. Për miratimin e lejes duhet vlerësimi pozitiv i të gjithë sektorëve.

4. Në çdo rast, duhet të kenë kaluar të paktën 3 muaj, nga miratimi i lejes shpërblyese të fundit.

5. Leja shpërblyese u jepet:

a) personave të dënuar deri në 3 vjet burgim, pasi të kenë vuajtur jo më pak se 1/4 e dënimit;

b) personave të dënuar nga 3 deri në 10 vjet burgim, pasi të kenë vuajtur jo më pak se 1/2 e dënimit;

c) personave të dënuar mbi 10 vjet burgim, pasi t’u ketë mbetur për të vuajtur më pak se 5 vjet heqje lirie.

6. Në rast refuzimi të dhënies së lejes, i dënuari ose përfaqësuesi i tij ligjor, ka të drejtë të bëjë ankim brenda 5 ditëve pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve ose Ministrit të Drejtësisë, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe më pas ka të drejtë të ankohet në gjykatë, e cila vendos për kërkesën për leje.

7. Procedurat e dhënies së lejeve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Drejtësisë”.

Një nga aktet nënligjore që normon të drejtën për leje shpërblyese, ashtu sikurse e përmendëm edhe më lart, është Udhëzimi Nr. 103, datë 14.02.2014 “Për rregullimin e disa çështjeve që kanë të bëjnë me procedurën e dhënies së lejeve shpërblyese apo të veçanta personave të dënuar me burgim”, i Ministrit të Drejtësisë.

Në mënyrë të detajuar në pikat 13³, 14⁴, 15 dhe 18⁵ të këtij akti përcaktohen procedura dhe kriteret që duhet të përmbushen që një shtetas i dënuar të mund të përfitojë nga kjo e drejtë.

Nga përmbajta e dispozitave të akteve normative të cituara më sipër rezulton se, *leja shpërblyese është parashikuar si një drejtë ligjore e cila u jepet të dënuarve të cilët plotësojnë kriteret ligjore:*

- a) të afatit të shlyerjes së masës së dënimit penal me burgim;
- b) kanë sjellje korrekte në IEVP-të;
- c) janë të motivuar për të marrë pjesë në programet rehabilituese e të riintegrimit;
- ç) nuk paraqesin rrezikshmëri shoqërore.

Këto janë kriteret e përcaktuara në mënyrë të përgjithshme në ligj, të cilat po në mënyrë të përgjithshme përmenden në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Ndërsa udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë bën një zbërthim më konkret se si do të vlerësohet kriteri i sjelljes së mirë, riintegrimit dhe rrezikshmërisë shoqërore. Pa dashur të përsërisim pikat e udhëzimit të renditura më lart po ndalemi tek takimet e të dënuarit me familjarët, objekt i hetimit tonë duke qenë se refuzimi i lejes shpërblyese për Dh. Ç. lidhet me mostakimin e ankuesit me ta. Në pikën 14 të tij, thuhet se *“Punonjësit e kujdesit social, përpara hartimit të raporteve për lejet shpërblyese, duhet të marrin në konsideratë masat e marra (të paktën një vit pa masa), **takimet me të afërmit, sjelljet me të burgosurit dhe punonjësit në institucion, natyrën dhe llojin e veprës së kryer**”*. Takimet e të dënuarit me të afërmit i mundësojnë stafit të institucionit ku ai vuan dënimin të kenë një ide më të qartë për qëndrimin e të dënuarit, shkallën e rehabilitimit dhe rrezikshmërinë e tij. Pra, nëse një i dënuar që shfaqet agresiv në takimet me familjarët, apo/dhe i cili mund të jetë dënuar për vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes⁶, nuk krijon besimin e një qëndrimi të mirë jashtë institucionit. Por, Udhëzimi nuk përcakton si kriter kufizues për dhënien e lejes shpërblyese mungesën e takimeve të të dënuarit me familjen. Takimi me familjen është një pjesë e të tërës, që çmohet bashkë me sjelljen e të dënuarit gjatë qëndrimit në IEVP.

Në paragrafin e dytë, të pikës III, të shkresës Nr.9657 Prot., datë 18.10.2017 *“Tërheqje vëmendje mbi problematikat e konstatuara në lidhje me praktikën e lejeve shpërblyese në IEVP”*, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, shkresë e referuar nga IEVP Peqin, si arsye për refuzimin e lejes shpërblyese të të dënuarit, thuhet se: *“Në rubrikën e vlerësimit të sjelljes, në lidhje me kontaktet familjare, stafet duhet të sqarojnë llojin e marrëdhënies me familjen*

³ Pika 13. *“Për të gjithë të dënuarit që do të shkojnë me leje shpërblyese, për të cilët ka informacione të pakonfirmuara se mund të kenë edhe dënime ose probleme në shtete të tjera, vendime gjyqi të tjera, brenda ose jashtë shtetit, duhet të kërkohet paraprakisht informacion për to në prokuroritë dhe komisariatet e vendbanimit të të dënuarve, për ekzistencën e vendimeve të tilla, hetimeve në vazhdim etj”*.

⁴ Pika 14. *“Punonjësit e kujdesit social, përpara hartimit të raporteve për lejet shpërblyese, duhet të marrin në konsideratë masat e marra (të paktën një vit pa masa), **takimet me të afërmit, sjelljet me të burgosurit dhe punonjësit në institucion, natyrën dhe llojin e veprës së kryer**”*.

⁵ Pika 18. *“Sjellja e të burgosurit vlerësohet e mirë në përputhje me kriteret e mëposhtme:*

- a) Kur i burgosuri nuk ka paraqitur rrezikshmëri të veçantë shoqërore, brenda një viti nga paraqitja e kërkesës.
- b) Kur gjatë vuajtjes së dënimit dhe në mënyrë të vazhdueshme i burgosuri ka shfaqur ndjenjë përgjegjësie dhe korrektesë në sjelljen e tij personale në marrëdhëniet me personelin e IEVP-së, si dhe në aktivitetet e organizuara nga institucioni.
- c) Kur i burgosuri krijon besimin e një qëndrimi të mirë jashtë institucionit.
- d) Kur i burgosuri tregon qëndrim korrekt dhe joagresiv ndaj personelit të IEVP-së, si dhe ndaj vizitorëve që hyjnë në institucion dhe nuk ka kryer kundër tyre veprime, që sipas Kodit Penal konsiderohen vepra penale.
- e) Kur i burgosuri ka respektuar afatet në rikthimin e tij në institucion, pas lejeve të mëparshme të dhëna.....”

⁶ Figura të veprave penale të parashikuara në Seksionin IX të Kodit Penal.

(biologjike apo të krijuar), duke specifikuar numrin e takimeve, personat që vijnë në takim, arsyet respektive në rast të mungesës së takimeve me familjarët”.

Në shkresën në fjalë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nuk shprehet nëse të dënuarit do t'i refuzohet kërkesa për leje shpërblyese kur ai nuk ka marrë takim me familjarët. Refuzimi i lejes të dënuarit Dh. Ç. me arsyetimin se ai nuk ka marrë takim me familjen në tre muajt e fundit dhe se i dënuari duhet të ketë familjen ku të shkojë dhe të kalojë ditët e lejes nuk gjen mbështetje ligjore. Shkaqet e mosrealizimit të shpeshtë të këtyre takimeve mund të jenë nga më të ndryshmet dhe që varen nga rrethana objektive, sikurse është pamundësia financiare apo shëndetësore e familjarëve, largësia e vendbanimit të familjarëve me institucionin ku vuajnë dënimin të dënuarit ose si në rastin në fjalë, ndodhja e familjes së afërt në një vend të huaj për arsye ekonomike. Përgjithësisht të dënuarit shkojnë me leje pranë familjes dhe kjo është një garanci më shumë për sjelljen e tyre jashtë institucionit, por ka edhe raste përjashtimore kur ata mund ta shpenzojnë këtë leje edhe me të afërm të tjerë apo vetëm në banesën e tyre. Qëllimi i parashikimit të kësaj të drejtë është që leja shpërblyese, të ndihmojë të dënuarit të ruajnë kontaktet apo rikrijonë kontaktet e humbura me të afërmit, miqtë apo dhe komunitetin ku ata do të banojnë e punojnë në të ardhmen. Pra, ky mekanizëm ligjor mundëson që ata të përgatiten për një kalim sa më të lehtë në jetën e lirë, pas periudhës së dënimit.

Do të ndalemi gjithashtu edhe në pikën II të shkresës Nr.9657 Prot., datë 18.10.2017 ku përcaktohet se: *“Në çdo rast, në momentin e daljes me leje të veçantë dhe shpërblyese, i dënuari duhet të pritet të paktën nga njëri nga pjesëtarët e familjes, i cili duhet të paraqesë dokumentin e tij të identifikimit. Familjari nënshkruan një deklaratë, sipas formatit bashkëlidhur”.* Duke mirëkuptuar pozitën e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për të patur një siguri të shtuar lidhur me të dënuarit që shkojnë me leje shpërblyese, për të shmangur rastet e subjektivitetit apo abuzimit të mundshëm nga ndonjë drejtues i IEVP-ve, çmojmë se edhe kjo pikë e shkresës Nr.9657 Prot., datë 18.10.2017 nuk merr parasysh situatat kur i dënuari është në pamundësi objektive për t'u pritur nga familjarët⁷.

Po ashtu, vlerësojmë se shkresa me lëndë: *“Tërheqje vëmendje mbi problematikat e konstatuara në lidhje me praktikën e lejeve shpërblyese në IEVP”* nuk është akt nënligjor dhe nuk mund të krijojë apo të vendosë kriteret të reja shtesë për dhënien e lejeve shpërblyese, përtej atyre që janë parashikuar në aktet normative të përmendura më sipër.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”* si dhe në mbështetje të nenit 21/b të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”*

REKOMANDOJMË:

Ndryshimin e udhëzimeve të dhëna nëpërmjet shkresës Nr.9657 Prot., datë 18.10.2017 *“Tërheqje vëmendje mbi problematikat e konstatuara në lidhje me praktikën e lejeve shpërblyese*

⁷ Për arsye objektive apo rrethana që i përmendëm më lart si, pamundësia financiare apo shëndetësore e familjarëve, largësia e vendbanimit të familjarëve me institucionin ku vuajnë dënimin të dënuarit etj.

në IEVP”, duke njehsuar praktikën në përputhje me legjislacionin që rregullon kriteret e dhënies së lejeve shpërblyese.

Bashkëlidhur rekomandimit do të gjeni fotokopje të praktikës së lejes shpërblyese për rastin e të dënuarit Dh. Ç. si dhe përgjigjet që kemi marrë nga IEVP Peqin dhe Komisariati i Policisë Sarandë.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi dhe masat që do të merrni për zbatimin e tij, na vini në dijeni brenda një afati kohor të përshtatshëm.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi

Përgatiti: Adil Skuqi, Ndhmëskomisioner